



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Raporti vjetor për vitin 2016



Prishtinë, Mars 2017

Rr. Armend Daci Nr. 1

Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (38) 240 252

Fax: +381 (38) 245 844

E-mail: ICMM@kosovo-mining.org

Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

HYRJE

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, mbi bazën e obligimeve ligjore që ka, ka përgaditur Raportin për punët e kryera gjatë vitit 2016 dhe të njëjtin është e obliguar ta publikojë në faqen zyrtare dhe ti dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës, këtë raport, i cili:

- analizon gjendjen e industrisë minerare në Kosovë; dhe
- bën një përmbledhje të të gjitha masave rregullatore, hetuese dhe zbatuese të marra nga KPMM gjatë vitit përkatës kalendarik; megjithatë, ky raport nuk duhet të përmbajë të dhëna lidhur me hetime të cilat janë në vazhdim e sipër, nëse këto të dhëna do të kërcënonin sekretin legjitim të hetimit.

Qëllimi i përgjithshëm i LMM-së përkatësisht i KPMM-së si zbatuese e ligjit është promovimi në përputhshmëri me standardet e pranura mjedisore, i hulumtimit, nxjerrjes dhe pasurimit të Mineraleve përmes rregullimit dhe mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, lehtësimi dhe mbështetja e një pjesëmarrje dhe konkurrence më të madhe të sektorit privat në industrinë minerare, maksimizimi i hulumtimit dhe shfrytëzimit të Mineraleve, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të të dhënave gjeo-shkencore në funksion të zhvillimit ekonomik për të mirën e Republikës së Kosovës. Ky raport prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e realizuar në bazë të këtyre qëllimeve, brenda një viti kalendarik.

Raporti i punës përmban punën dhe aktivitetin e bërë në fushën e gjeologjisë - hulumtimit, xehetarisë - shfrytëzimit, përpunimit dhe pasurimit, rezultatet e arritura gjatë vitit, problemet dhe sfidat me të cilat është ballafaquar ky rregullator gjatë punës së vet, si dhe objektivat e parapara për të ardhmen.

Përveç gjërave që u cekën më lartë raporti i punës i KPMM-së për vitin 2016 mëton të përfshin brenda vetes edhe punët të cilat janë kryer, mbi bazën frymës së rekomandimeve të dala gjatë vlerësimit të raportit paraprak të KPMM-së nga Komisioni Për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktur, Tregëti dhe Industri i Parlamentit të Republikës së Kosovës, e të cilat ishin shumë domethënëse sa i përket përmirësimit të klimës së investimeve në këtë sektor duke përmirësuar strukturën ligjore dhe duke harmonizuar kolozionet ligjore ndër-institucionale. Inkurajimi dhe bashkërendimi me të gjitha institucionet tjera shtetërore për parandalimin dhe ndalimin e ekonomisë joformale. Ngritja e nivelit të analizës lidhur me të arriturat dhe sfidat për rregullimin e këtij sektori dhe zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

Ky raport është organizuar mbi bazën e standardeve të formatuara për raportim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo ka këtë përmbajtje:

Përmbledhja ekzekutive, e cila përshkruan në tërësi raportin dhe jep një pasqyrim të përgjithshëm të punës së Institucionit;

Baza Ligjore, në të cilën është e listuar gjithë baza ligjore që rregullon funksionalitetin e institucionit, si dhe vështirësitë ligjore në zbatimin e përgjegjësi të veta;

Përshkrimi i Institucionit, e cila përmban përveç tjerash misionin, vizionin, qëllimin dhe kompetencat e KPMM-së, të parapara me Ligjin e Minierave dhe Mineraleve, po ashtu përshkruan organizmat me përgjegjësi kryesore në punën e KPMM-së.

Organizimi Institucional, është pjesa në të cilën paraqiten format dhe mënyrat e organizimit të brendshëm, në veçanti përmban të dhëna për Bordin, ekzekutivin dhe personelin e KPMM-së në përgjithësi.

Përshkrimi i fushës që e mbulon KPMM-ja, me rëndësi të veçantë, krahasimin e realizimit të planeve, veprimeve të ndërmarra dhe sfidat e tejkaluara dhe të planifikuara për të ardhmen.

Puna gjatë vitit paraprak, janë te fokusuara punët specifike të realizuara gjatë vitit 2016, si dhe sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak.

Raporti Financiar, është prezantuar buxheti dhe shpenzimet për vitin 2016, i shpalosur me detaje sipas kategorive dhe aktiviteteve të caktuara;

Raportimi rreth komenteve nga Zyra Kombëtare e Auditimi, në këtë pjese të raportit vjetor janë të prezantuara komentet e ZKA-së dhe adresimi i tyre nga menaxhmenti i KPMM-së, për raportin e auditimit të vitit paraprak; dhe

Anekset, është pjesa e fundit e cila përmban të dhëna shtesë të prezantuara në formë të ndryshme të përshtatura sipas natyrës dhe qasjes së informatës ose të dhënës.

Do theksuar, se edhe gjatë vitit 2016, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka bërë angazhim maksimal për luftimin e operatorëve pa licencuarë, të cilët me vite po i krijojnë probleme të mëdha këtij institucioni, atyre që operojnë në mënyrë legale, ambientit dhe buxhetit të Kosovës në veçanti.

Gjithashtu vlen të theksohet se përkrahje të pakursyer kemi pasur nga Policia e Kosovës. Kurse sa i përket bashkëpunimit me institucionet gjyqësore, në aspektin e efikasitetit dhe efektivitetit të procedimit për rastet e ngritura nga KPMM-ja, rezultatet mbeten edhe më tej të konsiderueshme. Edhe në këtë vit ka vazhduar procesi i aplikimit të procedurave përmbartimore për arkëtimin e borxheve të papaguara nga kategoria e gjobave administrative. Përderisa bashkëpunim jo të kënaqshëm ose mungesë përkrahje për çështjet e ndërlidhura me aktivitetin minierar kemi pasur me disa nga institucionet përgjegjëse të nivelit qendror dhe të atij lokal.

Me 24.03.2016, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka emëruar edhe anëtarin e pestë të Bordit të KPMM-së, me ç'rast është plotësuar në tërësi ky organ.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale do të vazhdojë me intensitet edhe më të shtuar gjatë vitit 2017, që t'i përkrah dhe mbështes në çdo aspekt të gjithë ata që merren ose pretendojnë të merren me industrinë minerare, njëkohësisht do t'i ndaloj, këshilloj dhe përmirësoj të gjitha ato që bien në kundërshtim me Ligjin dhe rregullat në fuqi për sektorin minierar.

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
PËRMBAJTJA	4
LISTA E TABELAVE	6
LISTA E FIGURAVE	7
SHKURTESAT:	9
1. PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE	10
1.1. Themelimi	10
1.2. Të arriturat	10
1.3. Objektivat	11
1.4. Analizë	12
1.5. Sfidat në të ardhmen	14
2. KORNIZA LIGJORE	16
2.1. Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale	16
2.2. Vështirësitë me të cilat është ballafaquar KPMM gjatë vitit 2016	16
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	18
3.1. Vizioni	18
3.2. Misioni	18
3.3. Fushëveprimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale	18
3.4. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e KPMM-së	18
3.5. Përgjegjësitë kryesore për menaxhimin e aktivitetit minerar në KPMM	19
4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON KPMM	20
4.1. Organizimi, veprimtaritë, personeli dhe niveli i rrogave	20
4.2. Bordi	20
4.3. Ekzekutivi	20
4.4. Burimet Njerëzore	22
4.5. Asetet e KPMM-së	24
4.6. Lokacioni i KPMM-së dhe hapësira fizike e objektit	24
5. AKTIVITETET PËR PERIU DHËN RAPORTUESE	25
5.1. Shqyrtimi dhe licencimi	25
5.1.1. Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim)	27
5.1.2. Licencat e shfrytëzimit	29
5.1.3. Lejet për Aktivitete të Veçanta	30
5.2. Resurset minerale dhe rëndësia e tyre në zhvillimin e vendit	31
5.2.1 Minierat e Plumb-Zingut (Pb-Zn)	31
5.2.2 Minierat nikel-kobaltit Ni-Co	32
5.2.3 Minierat e Kromit- Cr_2O_3	33
5.2.4 Mineralet energjetike – Linjiti	34
5.2.5 Andezite	36
5.2.6 Argjila	37
5.2.7 Gëlqeror	38
5.2.8 Bazalte	38
5.2.9 Dunite	39
5.2.10 Rërë dhe Zhavorr	40
5.2.11 Rërë kuarcore	40
5.2.12 Mergel	41
5.2.13 Rreshpe	42
5.3. Prezantimi i planifikimit të shfrytëzimit sipas lëndëve minerale për vitin 2017	43
5.3.1 Planifikimi i prodhimit të xehes së Plumb-Zingut (Pb-Zn) për vitin 2017	43
5.3.2 Planifikimi i prodhimit të xehes së Nikel - Kobaltit (Ni-Co) për vitin 2017	43
5.3.3 Planifikimi i prodhimit të xehes së Kromitit Cr_2O_3 për vitin 2017	44
5.3.4 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Linjiti	44
5.3.5 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Andezite	45
5.3.6 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Argjilës	46
5.3.7 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Gëlqeror	46
5.3.8 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Bazalt	46
5.3.9 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Dunit	47
5.3.10 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Rërës dhe zhavorrit	47
5.3.11 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Rërë kuarcore	48

5.3.12	Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Mergelë	48
5.3.13	Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Rreshpe.....	49
5.4.	Projektet	50
5.4.1	Kërkime Gjeofizike Elektrometrike në zonën e Guroreve pranë shpellës së Gadimes	50
5.4.2	Përpilimi i planit të Menagjimit të Resurseve Minerale të Kosovës, për vitin 2017	51
5.4.3	Skanimi i dokumentacionit gjeologjik te arkivit	52
5.5.	Inspektimi dhe monitorimi i aktiviteteve minerare	52
5.5.1.	Zhvillimi i aktiviteteve minerar në KEK.....	52
5.5.1.	Sasia e eksplozivit e përdorur gjatë vitit 2016.....	54
5.5.2.	Raporti i lëndimeve	54
6.	SFIDAT DHE REKOMANDIMET	55
6.1.	Parandalimi dhe Ndalimi i operimeve të jashtëligjshme dhe ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë	55
6.2.	Ngritja e kualitetit dhe sigurisë në pune në operimet minerare.....	55
6.3.	Mostrajtimi në kohë i lendeve te paraqitura në gjykata. Sanksionet Penale të Shqiptuara nga Gjykatat nuk po e arrijnë efektin e preventives në ndalimin e operimeve të jashtëligjshme.	56
7.	RAPORTIMI FINACIAR	58
8.	RAPORTIMI RRETH KOMENTEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	68
9.	SHTOJCAT.....	74

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Aktet nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë vitit 2016	16
Tabela 2: Pjesëmarrja e stafit të KPMM-së në trajnime gjatë vitit 2016	23
Tabela 3: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2016.....	27
Tabela 4: Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.....	28
Tabela 5: Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.....	28
Tabela 6: Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale.	29
Tabela 7: Lista e lejeve të lëshuara për vitin 2016 për leje për aktivitete të veçanta	30
Tabela 8: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Pb-Zn në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016.	31
Tabela 9: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Ni-Co në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	32
Tabela 10: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Cr ₂ O ₃ në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	33
Tabela 11: Rezervat e shfrytëzuara në vend burimet metalore për vitet 2013-2016.....	34
Tabela 12: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të linjtit në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016	34
Tabela 13: Rezervat e shfrytëzuara sipas lëndëve minerale ndërtimore gjatë vitit 2016	35
Tabela 14: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të andeziteve në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016	36
Tabela 15: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të argjilës në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016	37
Tabela 16: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të gëlqerorëve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	38
Tabela 17: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	38
Tabela 18: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të dunitëve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	39
Tabela 19: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Rërës dhe zhavorrit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016.....	40
Tabela 20: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Rërës kuarcore në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	41
Tabela 21: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Mergelës në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	41
Tabela 22: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të rreshpeve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	42
Tabela 23: Planifikimi dhe realizimi i djerrinës (mbulesës) për periudhën Janar – Dhjetor 2016 (m ³)...	53
Tabela 24: Numri i të lënduarëve në periudhën 2012-2016.....	54
Tabela 25: Buxheti i aprovuar në fillim të vitit 2016.....	58
Tabela 26: Buxheti pas rishikimit për vitin 2016.....	58
Tabela 27: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudhë të vitit 2016.....	59
Tabela 28: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për këtë periudhë të vitit 2016.....	60
Tabela 29: Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për mallra dhe shërbime në vitin 2016.....	61
Tabela 30: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitetin për vitin 2016	61
Tabela 31: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2016.....	62
Tabela 32: Krahësimi i shpenzimeve për vitet 2016-2013.....	63
Tabela 33: Vizitat jashtë vendit që janë realizuar në vitin 2016	64
Tabela 34: Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera.	65
Tabela 35: Inkasimi i të hyrave për vitin 2016.....	65
Tabela 36: Planifikimi i të hyrave për vitin 2016 dhe inkasimi i të hyrave për vitin 2016.....	66
Tabela 37: Inkasimi i të hyrave për vitet 2016-2013:	66
Tabela 38: Komentet (të gjeturat), Rekomandimet dhe nivelin e zbatueshmërisë së tyre për çdo komponent ose çështje të audituar.....	69

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Inkasimi i të hyrave per vitet 2016-2013	10
Figura 2. Raporti i licencave të hulumtimit dhe shfrytëzimit.....	12
Figura 3. Numri i licencave të mineraleve ndërtimore dhe industriale	13
Figura 4. Inkasimi i të hyrave gjatë viteve 2012-2016.....	13
Figura 5. Organogrami i KPMM-së	21
Figura 6. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së	22
Figura 7. Lokacioni i KPMM-së	24
Figura 8. Pranimi i aplikacioneve sipas muajve.....	25
Figura 9. Numri i aplikacioneve të pranuar, gjatë viteve 2012-2016	26
Figura 10. Numri i licencave dhe lejeve të lëshuara, gjatë viteve 2012-2016.....	26
Figura 11. Licencat/lejet e lëshuara gjatë vitit 2016	27
Figura 12. Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.	28
Figura 13. Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	28
Figura 14. Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale.....	29
Figura 15. Grafiku i lejeve të lëshuara gjatë vitit 2016.	30
Figura 16. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Pb-Zn në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016.	32
Figura 17. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Ni-Co në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	33
Figura 18. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Cr ₂ O ₃ në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	33
Figura 19. Rezervat e shfrytëzuar në vend burimet metalore në periudhën 2013-2016.....	34
Figura 20. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të linjitit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	35
Figura 21. Rezervat e shfrytëzuara të lëndëve minerale jo metalore gjatë vitit 2016	36
Figura 22. Raporti ne përqindje ne mes te planifikimit dhe realizimit të prodhimitarisë sipas lëndëve minerale jo metalore gjatë vitit 2016.....	36
Figura 23. Paraqitje e sasisë së shfrytëzuar të andeziteve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	37
Figura 24. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të argjilës në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016	37
Figura 25. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të gëlqerorëve në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016	38
Figura 26. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	39
Figura 27. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016.	39
Figura 28. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rërës dhe zhavorrit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016.....	40
Figura 29. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rërës kuarcore në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	41
Figura 30. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të mergelës në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	42
Figura 31. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rreshpeve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016	42
Figura 32. Paraqitje e prodhimitarisë së Pb-Zn dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	43
Figura 33. Paraqitje e prodhimitarisë së Ni-Co dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	44
Figura 34. Paraqitje e prodhimitarisë së Cr ₂ O ₃ dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	44
Figura 35. Paraqitje e prodhimitarisë së planifikuar të linjitit për 2016, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016	45
Figura 36. Paraqitje e prodhimitarisë së planifikuar të andezitit për 2017, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	45

Figura 37. Paraqitje e prodhimtarisë së planifikuar të argjilës për 2017, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016	46
Figura 38. Paraqitje e prodhimtarisë së gëlqerorëve dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	46
Figura 39. Paraqitje e prodhimtarisë së bazaltit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	47
Figura 40. Paraqitje e prodhimtarisë së bazaltit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	47
Figura 41. Paraqitje e prodhimtarisë së rërës-zhavorrit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	48
Figura 42. Paraqitje e prodhimtarisë së rërës kuarcore dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	48
Figura 43. Paraqitje e prodhimtarisë së mergelës dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	49
Figura 44. Paraqitje e prodhimtarisë së rreshpeve dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.....	49
Figura 45. Harta e izolinjave të rezistencës së dukshme	51
Figura 46. Planifikimi dhe realizimi i djerrinës	53
Figura 47. Krahësimin i planifikimit dhe realizimit të largimit të djerrinës për pesë vitet e fundit.....	54
Figura 48. Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2016.....	58
Figura 49. Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2016.....	59
Figura 50. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2016	60
Figura 51. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2016.....	60
Figura 52. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalin në vitin 2016	62
Figura 53. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2016	62
Figura 54. Krahësimi i shpenzime për vitet 2016-2013	63
Figura 55. Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera	65
Figura 56. Inkasimi i të hyrave për vitin 2016	66
Figura 57. Planifikimi i të hyrave për vitin 2016 dhe inkasimi i të hyrave për vitin 2016.....	66
Figura 58. Inkasimi i të hyrave për vitet 2016-2013.....	67

SHKURTESAT:

Au, Ag, Ni, Co, Pb, Zn,	Argjend, Nikel, Kobalt, Plumb, Zink, Ari
APK	Agjensioni Pyjor i Kosovës
Cr ₂ O ₃	Xehe kromit-Kromiti
Fe-Ni	FerroNikeli
GIS	Sistemi Gjeografik i Informimit (Geographic Information System)
GPS	Sistemi i pozicionimit të përgjithshëm (Global Positioning System)
Gjeo	Gjeologjike
IP	Polarizimi i provokuar
ISO 9001:2008	Standardi Ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë
K2	Shkëmbinj të fortë
K3	Rërë dhe zhavorr
KEK-DPQ	Korporata Energjetike e Kosovës-Divizioni për Prodhimin e Qymyrit
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
KSHA	Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave
LMM	Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-158
M1,	Minerale natyrore
M2,	Minerale industriale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operator Ekonomik
Pb-Zn	Plumb-Zink
PMRM	Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale
Rd	Rezistenca e dukshme
RKS	Republika e Kosovës
SP	Fusha elektrike natyrore
TM1-TM2-TM3-TM4	Raportime tremujore

PËRMBAJTJA E PËRGJITHSHME E RAPORTEVE

1. PËRMBLIDHJE EKZEKUTIVE

1.1. Themelimi

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është agjenci e pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-158 (tash e tutje LMM), me aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj, dhe Strategjinë Minerare. KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas LMM-së.

KPMM mbikëqyret nga Bordi i cili përbëhet prej 5 anëtarëve, të cilët sipas legjislacionit në fuqi kanë mandat 5 (pesë) vjeçar. Me pjesën ekzekutive të KPMM-së udhëheq Drejtori i cili ka mandat 3 (tre) vjeçar. Struktura dhe stafi tjetër i KPMM-së, përbëhet nga departamentet kryesore me staf profesional dhe njësitë tjera mbështetëse me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në KPMM gjatë vitit 2016 ishte 74 të punësuar, nga numri total i aprovuar që ka qenë 77.

1.2. Të arriturat

KPMM është organi përgjegjës për vlerësimin dhe arkëtimin e rentave minerare, taksën dhe gjobën administrative. Në vitin 2016 neto të inkasuar janë **31,209,899.00€ ose 105%** sa janë të planifikuara, përkatësisht 4% më shumë se në vitin paraprak (nga Renta Minerare 30,558,341.00€, nga Taksa Administrative 475,992.00€, nga Gjoka Administrative 191,795.00 € dhe të kthyer 19,229.00€).




Figura 1. Inkasimi i të hyrave per vitet 2016-2013

- Gjatë vitit 2016 Bordi i KPMM-së ka mbajtur **34** takime, në të cilat janë shqyrtuar **431** kërkesa për licenca dhe leje (në këtë numër janë përfshirë kërkesat e ndërmarrjeve që janë shqyrtuar më tepër se një herë si dhe kërkesat e ndërmarrjeve të pranuar para vitit **2016**).
- KPMM gjatë vitit 2016 ka pranuar gjithsej **239** kërkesa për licenca dhe leje për aktivitete të veçanta (Hulumtim **118**, Shfrytëzimi **51**, dhe Leje për Aktivitet të Veçantë **70**).
- Pas procedimit të të gjitha aplikacioneve të lartcekura sipas procedurave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi, brenda vitit 2016, janë lëshuar **191** Licenca dhe Leje (Hulumtim **83**, Shfrytëzimi **53**, dhe Leje për Aktivitet të Veçantë **55**).
- KPMM ka refuzuar për mos përmbushje të **kushteve për licencim**, **58** kërkesa për licenca dhe leje (Hulumtim **40**, Shfrytëzimi **13**, dhe Leje për Aktivitet të Veçantë **5**).
- Brenda vitit 2016 lëndë minerare, të shfrytëzuar sipas kategorive janë: Minerale Metalike Pb-Zn (251,405.00 ton), Fe-Ni (402,397.31ton), Minerale energjetike (lignit) 8,800,848.00ton, Minerale industriale (argjila) 256,481.83ton, Minerale ndërtimore 7,012,033.31m3.
- Përderisa, Gjatë vitit 2016 nga Inspektorati kemi pasur një dinamikë të lartë punës: **1897** vizita terreni, prej tyre **132** vizita të rregullta, **1535** inspektime të kërkesave dhe lejeve për minime masive, **59** transfere të eksplozivit në minierat nëntokësore, si dhe në bazë të kërkesave ditore kemi edhe **88** vizita të paplanifikuara terreni. Kurse nga **83** inspektime të aktiviteteve minerare të jashtëligjshme janë **identifikuar 40 operues pa licencuar**, ndaj të cilëve janë

ndërmarra masat e nevojshme nga Inspektorati, të parapara për veprimtarinë pa licencuara në fushën e minierave.

- Në këtë vit janë përcjell 41 kallëzime penale në Prokurorit kompetente, në bazë të raporteve që kanë ardhur nga terreni, për operime pa licencuara dhe janë në procedure të shqyrtimit nga gjykatat kompetente;
- KPMM-së gjatë vitit 2016 ka përgatitur 50 Aktvendime për Gjoha administrative lidhur me operimet pa licencuara, duke e respektuar ligjet dhe normat ligjore në fuqi;
- Duke pasur parasysh ndryshimet që kanë qenë pas ndarjes së buxhetit fillestar, buxheti i aprovuar ose final i KPMM-së për vitin 2016 ishte 1,240,762.86 €, përderisa i realizuar është 1,239,654.96 €, ose 99.91% e buxhetit final.
- Ndërsa ndarja finale e buxhetit nga kategoria ekonomike e kapitaleve për këtë vit ishte 119,260.00 € të shpërndara në 8 projekte. Me rishikim të buxhetit dhe vendimit të qeverisë. Vendimi Nr. 01/123, i dt. 28.03.2016, buxheti përfundimtar i KPMM-ës, në këtë kategori ekonomike ishte 106,846.09 €. Përderisa janë ekzekutuar 7 projekte me vlerë të përgjithshme 106,846.09€ ose shprehur në përqindje 99.99% e projekteve përkatësisht 89.95% e buxhetit të aprovuar për këtë kategori në fillim të vitit.
- KPMM gjatë vitit 2016 ka plotësuar edhe kornizën ligjore duke nxjerrur edhe 7 akte të reja nënligjore.
- Gjatë vitit 2016 KPMM-ja ka arritur të bashkërendis aktivitetet me shumë institucione tjera lidhur me një menaxhim më të mirë të sektorit minerar, duke përfshirë këtu të gjitha inspektoratet e komunave, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor, Policinë si dhe institucionet Ligjore Prokurorit e shtetit dhe Gjykatat.
- Gjatë vitit 2016 në terren Krahasuar me vitin Paraprak janë evidentuar shumë më pak operator të cilët kryejn veprimtari minerare pa licencë. Nga 65 sa ishin evidentuar dhe denoncuar në vitin 2015 këtë vitë janë evidentuar dhe denoncuar 40.

1.3. Objektivat

KPMM, parasheh që të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e detyrave dhe përgjegjësi të veta në të ardhmen përmes ngritjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të qeverisjes në përgjithësi dhe objektivave të caktuara në veçanti:

- Implementimi i Legjislacionit minerar, politikave dhe strategjisë minerare;
- Licencimi i ndërmarrjeve minerare në harmoni me LMM, planin për menaxhimin e resurseve minerale, Strategjinë minerare dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve minerale;
- Monitorimi – inspektimi si dhe zbatimi i të gjitha Ligjeve që ndërlidhen me sektorin minerar nga ana e ndërmarrjeve të licencuara, si dhe zbatimi i Planit të veprimit për parandalimin dhe ndalimin e operuesve të jashtëligjshëm;
- Tërheqja e Investitorëve përmes promovimeve të potencialit mineral që ka dhe ofron Kosova;
- Ngritja e nivelit të transparencës, komunikimit dhe avancimi i sistemit të teknologjisë informative për të mundësuar punë me efikasitet në KPMM dhe ofrim të shërbimeve për investitorët, kompani dhe qytetare.
- Parandalimi dhe ndalimi i ekonomisë joformale në fushën e Minierave.

1.4. Analizë

TË ARRITURA, SFIDAT DHE ADRESIMI I TYRE PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT MINERAR SI BAZË PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Edhe pse, Kosova ka të njohura rezerva të konsiderueshme të mineraleve metalore, energjetike, industriale dhe mineraleve ndërtimore, ende nuk ka gjetur mënyrën më të mirë për valorizimin e tyre, me theks të veçantë mineralet metalore dhe energjetike, gjë e cila duhet të jetë detyrë prioritare e institucioneve tona, që përmes planeve konkrete dhe infrastrukturës ligjore të favorshme, të hapin rrugë zhvillimit të qëndrueshëm të industrisë minerare e përmes saj zhvillimit ekonomik të vendit.

Vazhdimisht është theksuar se sektori minerar është njëri ndër sektorët më kryesor për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit, mirëpo edhe përkundër disa të arriturave të vazhdueshme, ende nuk është arritur që ky sektor të kontribuojë në masën e dëshirueshme në zhvillimin ekonomik të vendit.

Ne mendojmë se një zhvillim i qëndrueshëm i sektorit minerar mundë të arrihet duke u bazuar në potencialin që ka Kosova dhe duke u mbështetur në praktikat më të mira të vendeve që e kanë të zhvilluar këtë sektor.

Në këtë pikë KPMM ka bërë një analizë të shkurtë lidhur me rezultatet e rritura, sfidat dhe zgjidhjen/adresimin e tyre në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Licencat për mineralet metalore

KPMM-së edhe pse ka lëshuar **41** licencave për hulumtim të mineraleve metalike, vetëm **7** licenca janë aktive për shfrytëzimin e mineraleve metalike.




Figura 2. Raporti i licencave të hulumtimit dhe shfrytëzimit

Licencat për mineralet ndërtimore dhe industriale

Për dallim nga shfrytëzimi i mineraleve metalike shfrytëzimi i mineraleve ndërtimore dhe industriale ka shënuar një rritje me dinamikë të lartë duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe ndërtimin e vendit. KPMM ka lëshuar **127** licenca për shfrytëzim të gurit të forte dhe **9** licenca për minerale industriale të tjera siç janë; mergelët, argjilat, etj. Trendet edhe pse për momentin janë në rritje edhe për disa vite, në të ardhmen kjo do të ndryshoj pasi që nevojat e vendit për këto materiale do të zvogëlohen, prandaj në këtë fushë

duhet shikuar edhe mundësitë e rritjes së eksportit të materialeve ndërtimore të prodhuara në Kosovë.




Figura 3. Numri i licencave të mineraleve ndërtimore dhe industriale

Sido që të jetë sektori minerar në Republikën e Kosovës punëson rreth **12,000** të punësuar, si dhe ka pasur rritje të të hyrave nga Renta minerare nga 6 milionë sa ishte në vitin 2012 në mbi 31 milionë në vitin 2016, siç është paraqitur në grafikun më poshtë:




Figura 4. Inkasimi i të hyrave gjatë viteve 2012-2016

KPMM mendon se kjo ka ndodhur për disa arsye. Rritja e të hyrave është realizuar si rezultat i rritjes së rentës minerare për linjtit, si dhe si rezultat i krijimit të një stabiliteti të shfrytëzimit të mineraleve industriale dhe atyre ndërtimore dhe instalimit apo vënies së një disipline financiare në sektorin minerar. Duhet theksuar se; nga analiza e rentave minerare që KPMM ka kryer në vitin 2015, del se rentat minerare në vend janë të arsyeshëm.

Në vazhdim do të paraqesim disa nga faktorët kryesor të cilët janë edhe sfida reale dhe kanë ndikimin e drejtpërdrejt në krijimin e stabilitetit të sektorit minerar dhe rrjedhimisht edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar:

1. Statusi i padefinuar i Trepçës.
2. Moszhvillimi i Zonave me Interes të Veçantë të shpallura nga Qeveria.
3. Moszhvillimi i mineraleve energjetike – linjtit – mungesa e bazës ligjore adekuate për të nxitur shfrytëzimin e këtij resursi.
4. Nevojat për investime afatgjata në hulumtime për zbulim të zonave të reja të pasura me minerale metalike.

1. Statusi i padefinuar i Trepçës

Siç është e ditur statusi i pa definuar i kësaj ndërmarrje ka qenë penggesë e zhvillimit të saj. Tani pas aprovimit të Ligjit për Trepçën janë krijuar kushtet për zhvillimin e kësaj ndërmarrjeve respektivisht minierave të Trepçës. Prandaj rekomandohet që pa humbur kohë të fillohet me investime në minierat e Trepçës, sepse kjo do të ndikojë direkt në zhvillim të qëndrueshëm të sektorit si dhe rritje të zhvillimit ekonomik, punësimit dhe të hyrave për Republikën e Kosovës.

2. Moszhvillimi i Zonave me Interes të Veçantë të shpallura nga Qeveria

Në vitin 2008 në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale, Qeveria e Republikës së Kosovës ka shpallur 11 Zona me interes të Veçantë. Qëllimi i shpalljes së këtyre zonave ishte zbatimi i procedurave konkurruese dhe gjetja e investitorëve serioz. Këto zona janë zonat me perspektiv më të madhe për zhvillimin e sektorit minerar, mirëpo edhe për kundër perspektivës që kanë, ende nuk kanë filluar të zhvillohen. Kjo ka ndodhur si pasoj e lënies me ligj të përgjegjësive të shpërndara, procedimi përmes komiteteve ndërministrore dhe zyrave PPP të cilat në fakt nuk kanë funksionuar.

Duke pasur parasysh se ka kompani serioze të interesuara për këto zona, është nevojë imediate që të fillohet me shpalljen e tyre që të tërhiqen investime direkte në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit minerar.

3. Moszhvillimi i mineraleve energjetike –linjtit –

Mungesa e bazës ligjore adekuate për të nxitur shfrytëzimin e këtij resursi – Me Ligjin për Miniera dhe Minerale është paraparë që licencat për minerale energjetike të lëshohen përmes një procedure tenderuese që ka rezultuar të jetë shumë byrokratike dhe përveç lëshimit të licencave për linjit me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike nuk është lëshuar asnjë licence tjetër për shfrytëzim të mineraleve energjetike. Për kundër interesimit të kompanive për të shfrytëzuar këtë mineral për qëllime të përpunimit dhe prodhimit të produkteve të tjera. Pa humbur kohë duhet që të krijohet perspektiva e shfrytëzimit të linjtit edhe për qëllime të tjera ashtu siç parasheh strategjia minerare e RKS-së.

4. Nevojat për investime afatgjata në hulumtime për zbulim të zonave të reja të pasura me minerale metalike.

Hulumtimet afatgjate për zbulimin e zonave të reja metalore kërkojnë investime të mëdha financiare. Ne jemi dëshmitarë se sot në botë nga 100 shpime të kryera për kërkime të vendburimeve të reja metalore, konsiderohet sukses nëse njëra prej tyre jep rezultate pozitive. Përpos arritjes së rezultateve në hulumtime nevojitet edhe shpenzim i një periudha kohore të konsiderueshme dhe siguri i qëndrueshëm i mjeteve financiare për hulumtimin e vendburimeve të reja metalore në një zonë. Iniciativat për harmonizimin e Ligjeve të sektorëve tjerë me Ligjin për Miniera dhe Minerale, është nevojë imediate që të rregullohet njëherë e mirë, në mënyrë që mos të paraqiten barrierat të pa nevojshme sa i përket kohës së zgjatjes së licencave dhe sipërfaqeve të tyre.

1.5. Sfidat në të ardhmen

Duke marr parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me LMM-në dhe rregullat tjera në përgjithësi, në njërën anë dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për zbatimin e tyre në praktikë në anën tjetër, e kur kësaj i shtojmë edhe konceptet mbi trendet zhvillimore për këtë fushë, mund ta konsiderojmë si sfidë të veçantë për vet institucionet e RKS-së dhe gjithsesi sfidë për vet KPMM-në. Si sfida për arritjen e objektivave të parapara në të ardhmen, ne mund të veçojmë:

- Ngritja e kualitetit dhe sigurisë në punë në operimet minerare - Edhe pse funksionimi i sektorit minerar në Kosovë shoqërohet me siguri të mirë, prapë se prapë për Inspektoratin e

Minierave mbetet sfida që në bashkëpunim me institucionet relevante të përvetësojë dhe zbatoj standardet teknike dhe të sigurisë që zbatohen në vendet e BE-së;

- Mostrajtimi në kohë i lendeve të paraqitura në gjykata. Sanksionet Penale të Shqiptuara nga Gjykatat nuk po e arrijnë efektin e preventives në ndalimin e operimeve të jashtëligjshme;

- Parandalimi dhe ndalimi i aktiviteteve minerare të jashtë ligjshme - Një ndër sfidat kryesore të Inspektoratit të Minierave, edhe për vitin vijues do të jetë parandalimi i operatorëve të jashtë ligjshëm në sektorin e minierave si dhe sekuestrimi i mjeteve dhe lëndëve minerale të tyre.

- Hartimin dhe aprovimin e akteve nënligjore të nevojshme dhe domosdoshme për implementimin e LMM-se;

- Implementimi i vazhdueshëm i aktiviteteve që rrjedhin nga zbatim i Strategjisë minerare dhe Planit për Menaxhimin e Resurseve Minerale.

- Implementimi i vazhdueshëm i aktiviteteve që rrjedhin nga zbatim i politikave minerare.

2. KORNIZA LIGJORE

2.1. Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale

KPMM është themeluar me Rregulloren Nr. 2005/2 që ka hyrë në fuqi me datën 21 janar 2005, e cila është ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-081 për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2005/2 të datës 13 qershor 2008, ku përcaktohet si Agjenci e Pavarur në përputhje me nenin 119 paragrafi 5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës .

Veprimtarinë e vet, KPMM-ja e zhvillon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minerat dhe Mineralet i cili nga data 27 gusht 2010 ka hyrë në fuqi dhe është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Minerat dhe Mineralet i cili ka hyrë në fuqi me 02 maj 2013.

KPMM-ja rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra dhe Strategjinë Minerare, e cila vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas LMM-së.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura aktet e brendshme nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë vitit 2016.

Tabela 1: Aktet nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë vitit 2016

Udhëzime Administrative / Rregullore 2016
KPMM 2016_01 UA Per bashkim të licencave
KPMM 2016_02 UA Për mbikëqyrjen dhe inspektimin e bartësve të licencave që ushtrojnë aktivitete minerare
KPMM 2016_03 UA Për Taksat Administrative
KPMM 2016_04 UA Për shtyerjen dhe përjashtimin e pagesës së rentës minerare
KPMM 2016_05 UA Për rregullat e pajisjeve personale mbrojtëse dhe uniformën zyrtare për zyrtarët e terrenit në KPMM
KPMM 2016_06 UA Për ndryshimin dhe plotësimin e KPMM 2016_04 UA Për shtyerjen dhe përjashtimin e pagesës së rentës minerare
KPMM 2016_07 UA Për procedurën e shqyrtimit të ankesave

2.2. Vështirësitë me të cilat është ballafaquar KPMM gjatë vitit 2016

Punën dhe aktivitetin e KPMM-së gjatë vitit 2016 e kanë përcjell një mori vështirësi të cilat në raste të caktuara kanë ndërlikuar punën këtij institucioni mjaft të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës.

- Mos harmonizimi i ligjeve tjera me LMM-në. Gjatë punës së përditshme në zbatimin e dispozitave ligjore, KPMM ka hasur në vështirësi rreth sigurimeve dhe garancioneve që LMM i ka paraparë për ndërmarrjet e licencuara, kurse më vonë kjo çështje është rregulluar edhe me akte të mbrendeshme – Udhëzim Administrativ.

Sipas nenit 70 të LMM-së, Inspektorati i KPMM-së është kompetent për **sekuestrimit** e mjeteve të punës dhe lëndës minerale të operatorëve të pa licencuar që hasen në vendshfrytëzim.

Lidhur me këtë çështje kemi hasur në pengesa nga ana e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar, ku me rastin e sekuestrimit të mjeteve të punës, na është kërkuar vendim i veçantë nga gjykata kompetente për të pranuar makineritë e sekuestruara. Kjo çështje është sqaruar me shkrim nga Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, se nuk ka nevojë për vendim të veçantë nga gjykatat, sepse dispozitat e LMM-së e cekin shprehimisht se është kompetencë e KPMM-së sekuestrimi i mjeteve në rastet e veprimit të pa licencuar.

Problem në vete paraqet edhe çështja e zhvillimit të procedurës ligjore nëpër gjykata duke i lënë lëndët të vjetërsohen si dhe shqiptimi i masave joadekuat në raport me veprën penale të kryer

duke iu shqiptuar denime me kushte për veprimet e pa licencuara, gjë që nuk e ka efektin e duhur ligjor në shumë raste.

Mos harmonizimi i Ligjit për Pyjet e Kosoves me LMM-në, ngase kemi raste kur sipërfaqja që duhet të shfrytëzohet, në kopjen e planit dhe listën poseduese shkruan se kultura është mal, ndërsa APK-ja nuk është pronare e ngastrës dhe megjithëatë kërkohet pëlqim nga APK-ja.

Poashtu, APK-ja lëshohen pëlqime në sipërfaqe maksimale deri në 5 hektarë dhe në kohëzgjatje prej 5 viteve, kurse sipas LMM-së është e paraparë që kohëzgjatja e licencave për shfrytëzim të mineraleve ndërtimore mund të jetë deri 25 vite me mundësi vazhdimi edhe për 25 vite tjera. Kurse, për mineralet energjetike deri në 30 vite me mundësi vazhdimi edhe për 15 vite tjera.

KPMM-ja gjatë vitit 2016, ka bërë 41 kallzime penale në gjykata përkatëse për ndërmarrjet të cilat aktivitetin e vet minerar e kanë zhvilluar të pa licencuar.

KPMM-ja gjatë vitit 2016 ka përgatitur dhe i ka dërguar në adresat e duhura 50 Aktvendime për Gjyba administrative lidhur me operimet e pa licencuara.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. Vizioni

Krijimi i mjedisit institucional përmes shërbimeve cilesore, për rritjen e shpejtte të investimeve në sektorin mineral, forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e interesit të komunitetit dhe garantimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

3.2. Misioni

Hulumtimi dhe shfrytëzimi i resurseve minerare, zgjerimi e modernizimi i industrisë së përpunimit mineral për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqenies për qytetarët e Republikës së Kosovës.

3.3. Fushëveprimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

1. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është agjenci e pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me ligjin për minierat dhe mineralet, aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj, dhe Strategjinë Minerare.

3. KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale.

4. Paraqet vepër penale dhe shkelje të ligjit nëse një person ushtron ose tenton të ushtrojë ndikim politik, administrativ, financiar ose ndikim tjetër në KPMM-në, personelin ose menaxhmentin e saj.

3.4. Kompetencat dhe Përgjegjësitë e KPMM-së

1. KPMM ka autoritetin e përgjithshëm dhe përgjegjësinë për të siguruar:

1.1. Ligjshmerinë në hulumtimin dhe shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimtaritë minerare në Kosove;

1.2. Pajtueshmëria e operimeve minerare me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra në pajtim me ligjin dhe kushtet dhe afatet e licencave dhe lejeve të lëshuara nga KPMM, apo pëlqimeve të lëshuara si parakusht për miratim nga KPMM, në pajtim me ligj.

2. KPMM ka kompetencën për ushtrimin e funksioneve në vijim, në përputhje me Ligjit për Miniera dhe Minerale:

2.1. lëshimin, transferimin, vazhdimin, pezullimin dhe revokimin e Licencave dhe Lejeve;

2.2. themelimin dhe mirëmbajtjen e një kadastrë të minierave dhe një baze të të dhënave GIS që përmban të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të dhëna të tjera relevante ekonomike si dhe të gjithë titujt ekzistues të mineraleve dhe të drejtave minerare; dhe

2.3. nxjerrjen e rregullave për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të KPMM-së;

3. KPMM i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria.

4. Asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale ose çfarëdo aktiviteti tjetër pa licencë ose leje të lëshuar nga KPMM në përputhje me Ligjin për Minierat dhe Minerale;

5. KPMM-ja mund të lëshojë këto Licenca dhe Leje pas përmbushjes së kushteve për lëshimin e këtyre Licencave dhe Lejeve në bazë të Ligjit për Miniera dhe Minerale:

- 5.1. Licenca për hulumtim;
- 5.2. Licenca për mbajtjen e të drejtave;
- 5.3. Licenca për shfrytëzim;
- 5.4. Leja për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta;
- 5.5. Licenca për shfrytëzim zejtar;
- 5.6. Licenca ose Leja në Interes të Publikut.

3.5. Përgjegjësitë kryesore për menaxhimin e aktivitetit minerar në KPMM

Të gjitha kompetencat e KPMM-së ushtrohen nga Bordi i KPMM-së. Çdo vendim i cili sipas ligjit të minierave kërkohet të merret nga KPMM-ja duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM-së. Përderisa Drejtori i KPMM-së drejton veprimtarinë e zakonshme të KPMM-së dhe ushtron të gjitha funksionet e deleguara nga Bordi i KPMM-së.

Megjithatë, KPMM-ja funksionalizimin dhe realizimin efikas dhe efektiv të kompetencave dhe përgjegjësi të veta e realizon përmes organizmave profesional të ngritur në nivele departamentesh. Struktura e KPMM-së përbëhet nga departamentet kryesore dhe departamentet ose njësitë tjera mbështetëse për detyrat dhe përgjegjësitë e KPMM-së.

4. FUSHËVEPRIMI QË E MBULON KPMM

4.1. Organizimi, veprimtaritë, personeli dhe niveli i rrogave

Në përputhje me LMM-në, si dhe Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, KPMM e ka të rregulluar strukturën e vet organizative.

4.2. Bordi

KPMM drejtohet nga Bordi ("Bordi i KPMM") i cili përbëhet prej pesë (5) anëtarëve. Të gjitha kompetencat e KPMM ushtrohen nga Bordi. Çdo vendim i cili sipas ligjit kërkohet të merret nga KPMM duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM. Mandatet e të gjithë pasardhësve të anëtarëve fillestar janë pesë (5) vjet. Anëtarët e Bordit nuk e kane statusin e shërbyesit civil. Gjate ushtrimit te detyrave dhe përgjegjësiave te tyre sipas ligjit, anëtarët e bordit do të veprojnë ekskluzivisht në interes të publikut dhe me mirëbesim. Anetarët e bordit të KPMM-së emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi i KPMM-së, përveç takimeve të rregullta, me kërkesë të Drejtorit apo të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit organizon edhe takime shtesë.

Drejtori dhe stafi tjetër profesional përgatisin dhe shqyrtojnë kërkesat për licenca dhe leje, pastaj përmes takimeve të para-bordit bëhet seleksionimi i kërkesave që i plotësojnë kriteret për t'u përcjellë në Bord, në përputhje me ligjet në fuqi.

4.3. Ekzekutivi

Me pjesën ekzekutive të KPMM-së udhëheq Drejtori dhe Kryeinspektori. Drejtori është përgjegjës për të gjitha çështjet ekzekutive brenda KPMM-së, i cili bënë organizimin e takimeve të bordit, përgatitjen e raporteve sipas kërkesave për mbledhjet e Bordit dhe merret me ekzekutimin e vendimeve të marrura nga Bordi. Bazuar në legjislacionin në fuqi Drejtori ka mandat 3 vjeçar ndërsa Kryeinspektori ka mandat 5 vjeçar.

Menaxhmenti i mesëm në KPMM janë drejtorë të departamenteve dhe janë nëpunës civilë. Sipas ligjit për Shërbimin Civil të Republikës se Kosovës, nëpunësit civilë janë punëtorë të karrierës me afat të pacaktuar.

Në figurën më poshtë është paraqitur organogrami i KPMM-së.



4.4. Burimet Njerëzore

Me Ligjin Nr. 05/L-109 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, KPMM-së i janë aprovuar 77 pozita. KPMM-ja nuk ka arritur t'i plotësojë të gjitha pozitat e planifikuara dhe miratuara për shkak të shkurtimeve bugetore nga MF në qershor 2016. Deri në fund të vitit 2016 KPMM ka arritur t'i plotësojë 74 pozita.

KPMM ka personel me kuadër të kualifikuar, siç mund të shihet edhe në grafikun në vijim.




Figura 6. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së

Niveli i pagave të stafit në KPMM është i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Anëtarët e Bordit janë staf profesional të emëruar, dhe pagat e tyre janë të përcaktuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilat që nga viti 2007 nuk kanë ndryshuar. Drejtori dhe stafi tjetër ekzekutivë janë nëpunës civilë dhe pagat i kanë të përcaktuara sipas legjislacionit për shërbyes civilë (me koeficientë). Për shkak të natyrës specifike të punës së KPMM-së, përveç pagës bazë, stafi i KPMM-së ka të aprovuara nga MF dhe Kuvendi i Kosovës edhe shtesa në pagë, sipas specifikave të punës për pozita.

KPMM në mënyrë që të jetë më efikas në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi dhe veçanërisht në ndalimin e operuesve të pa licencuar në sektorin e minierave që do të rezultonte me krijimin e rendit në këtë sektorë dhe me rritjen e të hyrave direkt në KPMM dhe rritjen indirekte edhe të hyrave në Buxhetin e Kosovës për buxhetin e vitit 2018 ka parapare rritjen e numrit të stafit për 6 pozita si me poshtë:

1. Inspektor i Minierave Nëntokësore;
2. Inspektor i Minierave Sipërfaqësore;
3. Inspektor i Minierave – Elektrikë;
4. Gjeolog i Lartë – Gjeodatabazë;
5. Zyrtar i të Hyrave Financiare, dhe
6. Auditor i Brendshëm;

Gjatë vitit 2016 një numër i punëtorëve të KPMM-së ka marrë pjesë në trajnime si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Një numër i trajnimeve janë organizuar nga IKAP, por edhe një pjesë e trajnimeve janë organizuar nga institucione tjera brenda dhe jashtë vendit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detajet e trajnimeve të stafit të KPMM-së të realizuara gjatë vitit 2016:

Tabela 2: Pjesëmarrja e stafit të KPMM-së në trajnime gjatë vitit 2016

Ofruesi i Trajnimit	Lloji i trajnimit	Numri i pjesëmarrësve	Vendi	Kohëzgjatja
BM Consulting	Trajnim në Administratë	2	Shqipëri	4 ditë
IKAF	Trajnim në Kontabilitet	1	Prishtinë	vazhdimësi
IKT	Trajnim në Provim të Jurisprudencës	1	Prishtinë	8-22 shkurt 2016
CIPFA	Trajnim për Çertifikim të Auditorëve të brendshëm (provimi)	1	Prishtinë	1 ditë
Cactus	Trajnim për Databazë	1	Prishtinë	40 orë
IKM	Trajnim në Financa, Auditim dhe Prokurim	3	Turqi	5 ditë
UBT	Trajnim për Windows Server 2012	1	Prishtinë	80 orë
IKM	Trajnim për shfrytëzim të SIMBNJ	3	Kroaci	5 ditë
FLSA	Trajnim në Financa, Prokurim dhe Burime Njerëzore	1	Bullgari	4 ditë

4.5. Asetet e KPMM-së

Për kryerjen e aktiviteteve të veta, KPMM ka në posedim një numër të madh të aseteve funksionale si:

- Informacionet gjeoshkencore
- Gjeodatabazën e Kosovës
- Harduerë dhe Softuerë të avansuar
- Pajisje të Logjistikës (vetura) etj.

4.6. Lokacioni i KPMM-së dhe hapësira fizike e objektit

Objekti i zyreve të KPMM-së ndodhet në Breg të Diellit në rrugën Armend Daci, nr.1 në Prishtinë. Më poshtë është paraqitur harta e lokacionit të objektit të zyreve të KPMM-së.



Figura 7. Lokacioni i KPMM-së

Në mungesë të objektit të përhershëm për zyre, KPMM është e obliguar që merr me qera objekt privat me një hapësirë prej **1300 m²**, i cili përveç shpenzimeve të mëdha të qerasë, nuk i përmbush as kushtet si për nga hapësira e poashtu edhe nga funksionaliteti.

Edhe pse disa herë KPMM iu ka drejtuar institucioneve përkatëse me kërkesë që të vendoset në objektet e institucioneve publike, ende nuk është bërë një zgjidhje, prandaj KPMM vazhdon të qëndrojë me qera në objekte private, që nga viti 2004.

Vlen të theksohet se gjatë viteve 2010-2016, për hapësirë për zyre me qera KPMM ka shpenzuar nga Buxheti i Kosovës shumë prej **477,704.93 €**, ku gjatë vitit 2016 për zyre me qera KPMM ka shpenzuar **61,620.00 €**.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

5.1. Shqyrtimi dhe licencimi

Bordi i KPMM-së në takimet e mbajtura gjatë vitit 2016, përveç kërkesave të pranura gjatë vitit **2016** ka shqyrtuar edhe kërkesat e pranura në vitet paraprake.

KPMM-ë gjatë vitit **2016** ka pranuar gjithsej **239** kërkesa për licenca të hulumtimit dhe shfrytëzimit, si dhe kërkesa për leje për aktivitete të veçanta, prej tyre:

- Kërkesa për Licenca të hulumtimit – **118**.
- Kërkesa për Licenca të shfrytëzimit – **51**.
- Kërkesa për leje për aktivitete të veçanta **70** (separacione **40**, bazë betoni **22**, bazë asfalti **8**).
- Si dhe ka trajtuar 157 ankesa dhe kërkesa të ndermarrjeve apo personave fizik.

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur numri i aplikacioneve të pranura sipas muajve, gjatë vitit **2016**.




Figura 8. Pranimi i aplikacioneve sipas muajve.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur numri i aplikacioneve të pranura, gjatë viteve 2012-2016.




Figura 9. Numri i aplikacioneve të pranuar, gjatë viteve 2012-2016

Pas procedimit të të gjitha aplikacioneve të lartcekura sipas procedurave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi, janë lëshuar **191** Licenca dhe Leje për aktivitete të veçanta. Prej tyre janë: **83** licenca për hulumtim dhe **53** licenca për shfrytëzim, si dhe **55** Leje për aktivitete të veçanta (bazë asfalti **6**, bazë betoni **15**, separacione **32**, si dhe **2** Fabrik sortuese) – shih tabelën në vijim.

Pra, Bordi i KPMM-se gjate vitit **2016** gjithsejtë ka shqyrtuar **431** kërkesa-aplikacione të Hulumtimit kanë qenë **147**, **143** për shfrytëzim si dhe **141** për aktivitete të veçanta.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur nr. i licencave dhe lejeve të lëshuara, gjatë viteve **2012-2016**.





Figura 10. Numri i licencave dhe lejeve të lëshuara, gjatë viteve 2012-2016

Tabela 3: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2016

Nr. Rendor	Lloji i licences	Numri i licencave të aprovuara
1	Licenca për hulumtim	83
2	Licenca për shfrytëzim	53
3	Leje për aktivitete të veçanta	55
	Total	191

Ndryshimi në mes të aplikacioneve dhe licencave të aprovuara është se të gjitha kërkesat për licenca dhe Leje për Aktivitete të Veçanta nuk i kanë plotësuar kushtet Ligjore për t'u licencuar.

**Figura 11. Licencat/lejet e lëshuara gjatë vitit 2016**

5.1.1. Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim)

“Licencë për Hulumtim” nënkupton autorizimin zyrtar me shkrim të lëshuar nga KPMM në bazë të pjesës III të LMM-së.

Licenca për hulumtim të mineralet ndërtimore lëshohet në afat jo më shumë se 2 vite. Vlen për një zonë që nuk është më e madhe se 50 ha. Mund të vazhdohet edhe për një periudhë kohore maksimale prej 2 viteve.


Licencat e hulumtimit për të gjitha mineralet tjera lëshohen në afat prej jo më shumë se 3 vite. Vlen për një sipërfaqe jo më të madhe se 100 km², me mundësi vazhdimi për 2 herë, ku secili vazhdim nuk mund të jetë më i gjatë se 2 vite, pas çdo vazhdimi sipërfaqja e hulumtimit duhet të reduktohet për 50%.

Asnjë ndërmarrje nuk mund të mbajë licenca të shumëfishta për hulumtimin e mineraleve ndërtimore që mbulojnë në përgjithësi sipërfaqe më të madhe se 10 km², kurse për të gjitha mineralet tjera nuk mund të mbajë licenca të shumëfishta që mbulojnë në përgjithësi sipërfaqe më shumë se 300 km².

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i licencave për hulumtim të lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2016, sipas llojeve të lëndëve minerale.

Tabela 4: Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale

K-2 - shkëmbinj të fortë,	50
M-1 - Mineralet Metalike	16
M-2 - Matriali industrial	5
K-3 - rërë dhe zhavor	12
Totali	83


**Figura 12. Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.**

KPMM. Në bazë të nenit 59.1 dhe nenit 62 të LMM-së, pas shqyrtimit të aplikacioneve në përputhje me ligjin, Bordi KPMM-së i ka refuzuar disa nga kërkesat për licencim të hulumtimit, për mos-plotësimin e kushteve ligjore. Të gjitha ndërmarrjeve u është dërguar aktvendimi mbi arsyet e refuzimit.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale.

Tabela 5: Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale

Lloji i lëndës minerare	Nr. i licencave
Shkëmbinj të fortë,	23
Rërë dhe zhavor	8
Matriali industrial	5
Mineralet Metalike	4
Totali	40

**Figura 13. Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale**

5.1.2. Licencat e shfrytëzimit

Me “Licencë për Shfrytëzim” nënkupton licenca e lëshuar nga KPMM në bazë të pjesës V të LMM-së. Licencat për shfrytëzim për të gjitha mineralet, përveç mineraleve energjetike mund të lëshohen me kohëzgjatje maksimale prej 25 viteve me mundësi vazhdimi deri në 25 vite tjera. Licencat për shfrytëzim për mineralet energjetike kanë kohëzgjatje maksimale 30 vite me mundësi vazhdimi edhe për 15 vite të tjera.

Periudha kohore e një licence të shfrytëzimit caktohet sipas rezervave të shfrytëzueshme, projektit të shfrytëzimit dhe sipas dinamikës së shfrytëzimit.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të gjitha licencat për shfrytëzim të lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2016.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar numri i licencave për shfrytëzim të lëshuara nga KPMM gjatë vitit 2016, sipas llojeve të lëndëve minerale.

Tabela 6: Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale.

Shkëmbinj të fortë,	37
Matriali industrial	4
Mineralet Metalike	5
Rërë dhe zhavor	7
Totali	53




Figura 14. Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale

Në bazë të nenit 59.1 dhe nenit 62 të LMM-së, pas shqyrtimit të aplikacioneve në përputhje me ligjin, Bordi KPMM-së i ka refuzuar disa nga kërkesat për licencim të Shfrytëzimit, për mos-plotësimin e kushteve ligjore. Të gjitha ndërmarrjeve u është dërguar aktvendimi mbi arsyet e refuzimit.

- **Pezullimi i licencave** - Në bazë të procedurave administrative të nenit 9.1 të LMM-së, duke u bazuar edhe në vendimet perkatëse nga institucionet tjera, për ndërmarrjet të cilat nuk kanë arritur t'i ruajnë kualifikimet sipas nenit 9.1 të LMM-së, KPMM ka bërë pezullimin 74 e licencave të shfrytëzimit. Të gjitha ndërmarrjeve u është dërguar aktvendimi mbi arsyet e pezullimit.

- Bartja e kontrollit - Me “Bartje të Kontrollit” nënkuptohet licencë e lëshuar nga KPMM në bazë të nenit 59.1 nenit 62 dhe në përputhje me nenin 11 të LMM-së. KPMM, pas shqyrtimit të kërkesave për bartje të kontrollit gjatë vitit 2016.

5.1.3. Lejet për Aktivitete të Veçanta

Me “Leje për Aktivitete të Veçanta” nënkuptohet leja e lëshuar nga KPMM në bazë të pjesës VI të LMM-së. Kohëzgjatja dhe fushëveprimi i çdo Leje përcaktohet nga KPMM-ja, në përputhje me LMM, në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtpërdrejt dhe racionale në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve të veçanta të autorizuara me Lejen në fjalë.

Në grupin e Lejeve për Aktivitete të Veçanta përfshihen:

- Leje për përdorimin e lëndëve plasëse për nevojat e sektorit mineral,
- Leje për punë në xehetari:
 - Përdorimi ose funksionimi i makinerisë apo i pajimeve ose
- Leje për përpunimin e lëndëve të para minerale:
 - Përdorimi ose funksionimi i makinerisë apo pajimeve (gurëthyes me separacion, bazë e betonit dhe bazë e asfaltit),
 - Përdorimi i kemikateve ose reagjentëve të tjerë, ose

Më poshtë është paraqitur në mënyrë tabelare dhe grafike numri i të gjitha lejeve të lëshuara në vitin 2016 për Leje për aktivitete të veçanta si dhe është bërë krahasimin në formë grafike.

Tabela 7: Lista e lejeve të lëshuara për vitin 2016 për leje për aktivitete të veçanta

Sortues	6
Baza e betonit	15
Baza e asfaltit	32
Fabrikë Sortuese	2
Totali	55




Figura 15. Grafiku i lejeve të lëshuara gjatë vitit 2016.

KPMM, në bazë të nenit 59.1 dhe nenit 62 të LMM-së, pas shqyrtimit të kërkesave në përputhje me ligjin, për mos-plotësimin e kushteve ligjore KPMM i ka refuzuar kërkesat për Leje të Aktiviteteve të veçanta. Të gjitha ndërmarrjeve u është dërguar aktvendimi mbi arsyet e refuzimit.

Gjatë vitit 2016 janë shqyrtuar gjithsej 5 kërkesa për mbylljen e licencave të shfrytëzimit. KPMM në bashkëpunim me institucionet e tjera si: MMPH dhe AKP, pas fazës së skadimit të licencave ka bërë rikultivim i zonave të licencave.

5.2. Resurset minerale dhe rëndësia e tyre në zhvillimin e vendit

Kosova është e pasur me resurse minerale, nga të cilat resurset minerale energjetike dhe të metaleve më ngjyrë paraqesin potencial të rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit. Vendburimet më të rëndësishme janë vendburimet e: qymyrit, plumbit-zinkut (të bashkëshoqëruara më Au dhe Ag), Ni-Co, Ni-Co, boksitit, manganit etj. Kosova po ashtu është e pasur dhe më një numër të konsiderueshëm të vendburimeve jo-metallore, industriale por edhe ujin mineral e termal si dhe burimet e energjisë gjeotermale. Shfrytëzimi racional dhe i menaxhuar mirë i këtyre resurseve është bazë për një zhvillim më të shpejtë e të qëndrueshëm ekonomik e social. Resurset minerale janë pasuri e rëndësishme kombëtare, nxjerrja dhe shfrytëzimi i tyre paraqet një kontribut thelbësor për ekonominë në Kosovë. Në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit dhe njëkohësisht dhe në ruajtjen e pasurive natyrore të jo ripërtriteshme do të kontribuonte dhe shfrytëzimi i resurseve të ripërtritëshme; resurset ujore, energjisë së erës, energjisë diellore, po ashtu dhe materialet e riciklueshme mund të plotësojnë një pjesë të kërkesave. Në vitet e fundit janë bërë përpjekje të shumta për sistematizim të dhënave ekzistuese, në veçanti në këto dy vitet e fundit ka pas përparim të dukshëm ngase është bërë avancimi i Gjeo-databazës ekzistuese, dhe po ashtu bërë kalimi i menaxhimit të resurseve të shfrytëzuara nga baza paraprake në Gjeo-data bazë, e munduruar kjo nga krijimi i moduli të veçantë për raportimet e ndërmarrjeve. Gjatë këtij viti kemi filluar dhe pasurimin më informacione të reja dhe inkomporomi i të gjithave së bashku në gjeo-databazë në mënyrë që të jen të qasshme për të interesuar.

Prezantim statistikor i rezervave të shfrytëzuara sipas viteve të lëndëve minerale metallore.

Në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm është paraqitur realizimi i prodhimtarisë sipas lëndëve minerale për periudhën kohore 2013-2016.

5.2.1 Minierat e Plumb-Zingut (Pb-Zn)

Në Kosovë shfrytëzimi Pb-Zn bëhet në 4 miniera nëntokësore dhe atë: Belloberdë, Cernac, Stantergë dhe Artanë. Nxjerrja e xehes nga miniera bëhet në sasi të vogël. Produkti final është koncentrat i Pb dhe Zn, kjo në mungesë të shkrites, e tërë sasia e koncentratit eksportohet jashtë vendit. Në tabelën dhe grafikun e më poshtëm janë paraqitur raportimet nga ndërmarrjet, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Tabela 8: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Pb-Zn në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016.

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjeve	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)	Përmbajta e metalit		
	ton		në %			
a	b	c	d=100*c/b	Pb%	Zn%	Ag gr/t
2013	284,948.00	252,768.27	88.71	3.02%	2.90%	47.16
2014	411,674.00	282,253.80	68.56	2.79%	2.72%	42.21
2015	481,355.20	251,448.00	52.24	2.81%	2.56%	38.97
2016	457,943.00	251,405.00	54.90	3.22%	3.13%	43.52

Nga siç mund të vërehet në tabelën e më sipërme dhe në grafikun e më poshtëm nuk ka ndryshim të madh në mes të planifikimit dhe realizimit.




Figura 16. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Pb-Zn në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016.

5.2.2 Minierat nikel-kobaltit Ni-Co

Në Kosovë shfrytëzimi i xehes së Ni-Co është sipërfaqësor, numri i minierave të licencuara për shfrytëzim ka qenë i ndryshueshëm. Xehja e Ni-Co kalon në produkt final (Shkrihet) dhe si i tillë eksportohet, xehja e Ni-Co importohet dhe nga jashtë për tu shkrirë në shkritoren në Drenas.

Në tabelën dhe grafikun e më poshtëm janë paraqitur raportimet nga ndërmarrja për periudhën 2013-2016

Tabela 9: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Ni-Co në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjeve	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)	Përmbajta e metalit	
	t		në %	Ni%	Co%
a	b	c	d=100*c/b		
2013	640,000.00	623,504.20	97.42	1.22%	0.08%
2014	893,999.97	565,056.28	63.21	1.19%	0.05%
2015	1,282,994.41	651,918.51	50.81	1.02%	0.04%
2016	797,879.00	402,397.31	50.43	1.07%	0.07%




Figura 17. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Ni-Co në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Prodhimtaria e xehes së Ni-Co sipas shfrytëzimit të gjertanishëm nga ka pësuar ndryshime në sasinë e rezervave të shfrytëzuara sipas viteve.

5.2.3 Minierat e Kromit– Cr_2O_3

Në Kosovë shfrytëzimi Cr_2O_3 behët në shfrytëzim sipërfaqësor, për momentin kemi vetëm një licencë shfrytëzimi. Xehja e Cr_2O_3 shitet si e sortuar vetëm më dorë, si i tillë eksportohet. Në tabelën dhe grafikun e më poshtëm janë paraqitur raportimet nga ndërmarrja.

Tabela 10: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Cr_2O_3 në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjeve	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)	Përmbajta e metalit
a	b	c	d=100*c/b	$\text{Cr}_2\text{O}_3\%$
2013	10,000.00	2,977.70	29.78	28.00%
2014	10,000.00	3,750.20	37.50	27.00%
2015	7,500.00	0.00	0.00	0.00%
2016	0.00	0.00		




Figura 18. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të xehes së Cr_2O_3 në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Siç po vërehet nga grafiku në dy vitet e fundit shfrytëzimi është ndërprerë në tërësi.

Rezervat e shfrytëzuar nga të gjitha licencat që shfrytëzojnë lëndë minerale metalore janë të paraqitura në tabelën dhe grafikun e më poshtëm.

Rezervat e shfrytëzuar nga të gjitha licencat që shfrytëzojnë lëndë minerale metalore janë të paraqitura në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tabela 11: Rezervat e shfrytëzuara në vend burimet metalore për vitet 2013-2016

Viti	Paraqitje tabelore e realizimit të prodhimit sipas lëndëve minerale gjatë 2013-2016		
	Pb-Zn	Ni-Co	Cr ₂ O ₃
2013	252,768.27	623,504.20	2,977.70
2014	282,253.80	565,056.28	3,750.20
2015	251,448.00	651,918.51	0.00
2016	251,405.00	402,397.31	0.00




Figura 19. Rezervat e shfrytëzuar në vend burimet metalore në periudhën 2013-2016

5.2.4 Mineralet energjetike – Linjiti

Të dhënat mbi planifikimin dhe rezervat e shfrytëzuara gjatë vitit 2016 për lëndët minerale energjetike dhe ndërtimore janë të paraqitura në tabelat dhe grafiket në vazhdim. Gjithashtu përqindja e realizimit të prodhimit tek të gjitha lëndët minerale është llogaritur nga raporti në mes të planifikimit dhe realizimit, bazuar kjo në raportimet e ndërmarrjeve.

Momentalisht KPMM i ka të lëshuara dy licenca aktive për shfrytëzim të linjtit, Obiliq dhe Sibovc. Sasia e linjtit të shfrytëzuar është paraqitur në formë tabelore dhe në grafik në tabelën dhe grafikun e më poshtëm.

Tabela 12: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të linjtit në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	ton		në %
2013	8,080,000.00	8,219,393.00	101.73
2014	8,000,000.00	7,204,211.00	90.05
2015	8,000,000.00	8,240,994.00	103.01
2016	8,400,000.00	8,800,848.00	104.77




Figura 20. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të linjit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Nga grafiku i më sipërm vërehet se ndërmarrja ka planifikim dhe realizim përafërsisht të përputhshëm.

Mineralet ndërtimore

Përmbledhje e rezervave të shfrytëzuara sipas lëndëve minerale ndërtimore dhe raporti në përqindje në mes të planifikimit dhe realizimit, është paraqitur në tabelën dhe grafikët e më poshtëm

Tabela 13: Rezervat e shfrytëzuara sipas lëndëve minerale ndërtimore gjatë vitit 2016

Lënda minerale	Planifikimi nga ndërmarrjet-2016	Planifikimi sipas PMRM-2016	Realizimi gjatë vitit 2016	Raporti Planifikim i ndërmarrjeve-Realizim në (%)	Raporti Planifikim i PMRM (2016)-Realizim në (%)	Njësia
Andezite (m ³)	652,200.00	200,000.00	16,140.24	2.47%	8.07%	m ³
Argjilla (t)	668,561.00	100,000.00	330,609.14	49.45%	330.61%	t
Gëlqeror (m ³)	8,656,106.00	5,000,000.00	6,450,017.82	74.51%	129.00%	m ³
Bazalte (m ³)	118,900.00	4,800.00	0.00	0.00%	0.00%	m ³
Rërë dhe zhavorr (m ³)	35,880.00	15,000.00	11,342.20	31.61%	75.61%	m ³
Rëra kuarcore (m ³)	110,600.00	25,000.00	17,510.00	15.83%	70.04%	m ³
Dunite (m ³)	638,570.70	400,000.00	206,685.04	32.37%	51.67%	m ³
Mergelë (m ³)	707,000.00	280,000.00	320,378.00	45.32%	114.42%	m ³
Rreshpe (m ³)	10,000.00	1,500.00	1,369.02	13.69%	91.27%	m ³




Figura 21. Rezervat e shfrytëzuara të lëndëve minerale jo metalore gjatë vitit 2016




Figura 22. Raporti në përqindje në mes të planifikimit dhe realizimit të prodhimit sipas lëndëve minerale jo metalore gjatë vitit 2016

5.2.5 Andezite

Shfrytëzimi i andeziteve për vendburime të veçanta bëhet me minim dhe pa minim në bazuar në specifikat të vendburimit, duke pas parasysh këtë në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm janë paraqitur raportimet nga ndërmarrjet dhe minimet sipas viteve.

Tabela 14: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të andeziteve në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga minimet)	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	m³			në %
a	b	c	d	e=100*c/b
2013	458,440.00	0.00	3,573.00	0.78
2014	458,440.00	0.00	3,573.00	0.78
2015	858,440.00	269,132.70	263,485.16	30.69
2016	652,200.00	14,090.24	16,140.24	2.47




Figura 23. Paraqitje e sasisë së shfrytëzuar të andeziteve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Nga grafiku i më sipërm vërehet se ka një ndryshim të madh në mes të planifikimit dhe realizimit, ndërsa ka një përputhshmëri pothuajse të përafërt në mes të raportimit të ndërmarrjeve dhe raportimit nga minimet, që do të thotë se kemi raportim real të ndërmarrjeve.

5.2.6 Argjila

Shfrytëzimi i Argjilës për vendburime të veçanta është paraqit në tabelën dhe grafikun e më poshtëm.

Tabela 15: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të argjilës në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	ton		në %
2013	481,950.00	85,133.89	17.66
2014	481,950.00	113,969.14	23.65
2015	308,110.75	131,191.22	42.58
2016	668,561.00	330,609.14	49.45




Figura 24. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të argjilës në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Nga grafiku i më sipërm vërehet se ka ndryshim të madhe në mes të planifikimit dhe realizimit, që nënkupton se ndërmarrjet nuk e kanë përshtat planifikimin me realizimin. Sipas grafikut të më sipërm mundë të vërehet se nga viti 2013 ka ngritje graduale të sasisë së shfrytëzuar të argjilave.

5.2.7 Gëlqeror

Shfrytëzimi i gëlqerorëve për vendburime të veçanta bëhet me minim dhe pa minim sipas specifikave të vendburimit, duke pas parasysh këtë në tabelën dhe grafikun e më poshtëm janë paraqitur raportimet nga ndërmarrjet dhe minimet në vitet gjegjëse, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.

Tabela 16: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të gëlqerorëve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga minimet)	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Minim)
	m ³			në %
2013	9,156,190.40	4,860,614.67	5,031,624.46	53.09
2014	8,348,696.00	3,610,924.61	3,680,524.00	43.25
2015	8,376,836.00	6,215,548.44	6,244,638.45	74.20
2016	8,656,106.00	6,450,017.82	6,407,101.72	74.51




Figura 25. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të gëlqerorëve në tërë territorin e Kosovës, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Nga grafiku i më sipërm vërehet se ka një ndryshim të dukshëm në mes të planifikimit dhe realizimit, ndërsa ndryshimi në mes të raportimit nga minimet dhe raportimit të ndërmarrjeve është mjaft i vogël që nënkupton se ndërmarrjet që shfrytëzojnë gëlqeror kanë bërë raportime më reale. Sipas grafikut të më sipërm mund të vërehet se gjatë viteve ka lëvizje periodikes sa i përket planifikimit dhe realizimit të sasisë së shfrytëzuar të gëlqerorëve.

5.2.8 Bazalte

Shfrytëzimi i bazaltit për vendburime të veçanta bëhet me minim dhe pa minim e bazuar kjo në specifikat të vendburimeve, duke pas parasysh këtë në tabelën dhe grafikun e më poshtëm janë paraqitur raportimet nga ndërmarrjet dhe minimet në vitet gjegjëse, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.

Tabela 17: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga minimet)	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Minim)
	m ³			në %
2013	118,900.00	9,704.70	9,704.70	8.16
2014	118,900.00	10,942.51	10,964.18	9.20
2015	118,900.00	8,271.34	8,271.34	6.96

2016	118,900.00	0.00	0.00	0.00
------	------------	------	------	------




Figura 26. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Nga tabela dhe grafiku i më sipërme mund të vërehet se ka ndryshim të madh në mes të planifikimit dhe realizimit. Ndërsa ka përputhje të përafërt në mes të raportimit nga ndërmarrjet dhe minimi.

5.2.9 Dunite

Shfrytëzimi i dunitëve për vendburime të veçanta bëhet më minim sipas specifikave të vendburimeve. Duke pas parasysh këtë, në tabelën dhe grafikun e më poshtëm janë paraqitur rezervat e shfrytëzuara sipas raportimeve nga ndërmarrjet dhe minimet, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.

Tabela 18: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të dunitëve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga minimet)	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Minim)
	m³			në %
2013	254,400.00	1,783,317.39	1,783,317.21	700.99
2014	185,760.88	206,116.98	0.00	110.96
2015	405,400.00	160,219.11	160,219.11	39.52
2016	638,570.70	206,685.04	206,685.04	32.37




Figura 27. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të bazaltit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016.

Nga tabela dhe grafiku i më sipërme mund të vërehet se ka ndryshim të madh në mes të planifikimit dhe realizimit. Ndërsa ka përputhje të përafërt në mes të raportimit nga ndërmarrjet dhe minimi.

5.2.10 Rërë dhe Zhavorr

Shfrytëzimi i Rërës dhe zhavorrit për vendburime të veçanta është paraqit në tabelën dhe grafikun e më poshtëm, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.

Tabela 19: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Rërës dhe zhavorrit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	m ³		në %
2013	75,114.00	25,398.55	33.81
2014	71,635.50	26,142.10	36.49
2015	50,150.00	8,287.80	16.53
2016	35,880.00	11,342.20	31.61




Figura 28. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rërës dhe zhavorrit në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016


Nga grafiku i më sipërm vërehet se ka ndryshim të dukshëm në mes të planifikimit dhe realizimit. Sipas grafikut të më sipërm vërehet se gjatë vitit 2015 ka pas rënie të sasisë së shfrytëzuar, ndërsa gjatë vitit 2016 serish ka tendencë rritje.

5.2.11 Rërë kuarcore

Shfrytëzimi i Rërës kuarcore për vendburime të veçanta është paraqit në tabelën dhe grafikun e më poshtëm, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.

Tabela 20: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Rërës kuarcore në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	m ³		në %
2013	230,500.00	27,371.00	11.87
2014	141,500.00	120,667.70	85.28
2015	147,000.00	16,807.00	11.43
2016	110,600.00	17,510.00	15.83

**Figura 29. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rërës kuarcore në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016**

Nga tabela dhe grafiku i më sipërm mund të vërehet se ka ndryshim të madh në mes të planifikimit dhe realizimit. Ndërsa sasia e raportuar ndër vite ka pak ndryshime. Tek ndërmarrjet që shfrytëzojnë rërë kuarcore po ashtu është vështirë më bërë planifikim real, ngase ka shfrytëzues të pa ligjshëm

5.2.12 Mergel

Shfrytëzimi i Mergëles për vendburime të veçanta janë paraqitë në tabelën dhe grafikun e më poshtëm, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Tabela 21: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të Mergelës në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi-(Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	m ³		në %
2013	1,360,307.00	411,073.00	30.22
2014	1,140,000.00	310,953.00	27.28
2015	1,303,800.00	284,962.00	21.86
2016	707,000.00	320,378.00	45.32




Figura 30. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të mergelës në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Nga grafiku i më sipërm vërehet se planifikimi dhe shfrytëzimi i mërgelës ka pas mospërputhje të madhe në vazhdimësi, ndërsa prodhimtaria ka qenë më ndryshime ritmike.

5.2.13 Rreshpe

Shfrytëzimi i rreshpeve për vendburime të veçanta është paraqit në tabelën dhe grafikun e më poshtëm, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016.

Tabela 22: Paraqitje tabelore e sasisë së shfrytëzuar të rreshpeve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Viti	Planifikim sipas ndërmarrjes	Realizimi - (Raportim nga ndërmarrjet)	Raporti (Planifikim-Raportim)
	m³		në %
2013	10,000.00	4,600.00	46.00
2014	10,000.00	5,146.00	51.46
2015	10,000.00	900.00	9.00
2016	10,000.00	1,369.02	13.69




Figura 31. Paraqitje në grafik e sasisë së shfrytëzuar të rreshpeve në tërë territorin e Kosovës, në periudhën kohore 2013-2016

Nga grafiku i më sipërm vërehet se shfrytëzimi i rreshpeve ka qenë më ndërprerje dhe në vazhdimësi ka pas mospërputhje të madhe.

5.3. Prezantim i planifikimit të shfrytëzimit sipas lëndëve minerale për vitin 2017

Si formë më e përshtatshme për analizë të tillë është marr për bazë e “mesmja e lëvizshme” e bazuar kjo po ashtu në periudhën 2013-2016.

Në grafiket e mëposhtëm është paraqitur planifikimi i prodhimit sipas lëndëve minerale e bazuar kjo në prodhimtarin e realizuar gjatë periudhës kohore 2013-2016.

5.3.1 Planifikimi i prodhimit të xehes së Plumb-Zingut (Pb-Zn) për vitin 2017

Për planifikim të prodhimit për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2013- 2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 32. Paraqitje e prodhimit të Pb-Zn dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Prodhimtaria e xehes së Pb-Zn ka pësuar ndryshime të vazhdueshme gjë që mundë të vërehet dhe në grafikun e më sipërm. Bazuar në mesataren e lëvizshme planifikimi i prodhimit për vitin 2017 planifikohet të jetë rreth 256,000.00 ton

5.3.2 Planifikimi i prodhimit të xehes së Nikel - Kobaltit (Ni-Co) për vitin 2017

Për planifikim të prodhimit për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2013-2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 33. Paraqitje e prodhimit të Ni-Co dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Prodhimtaria e xehes së Ni-Co sipas shfrytëzimit të gjertanishëm ka pësuar disa luhajtje, siç dhe mund të vërehet në grafikun e më sipërm në vitin 2014 ka pas rënie të sasisë së shfrytëzuar të xehes ndërsa në vitin 2015 kemi pas rritje, dhe serish ka pësuar rënie gjatë vitit 2016. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të xehes së Ni-Co për vitin 2017 mund të jetë 480,000.00 ton.

5.3.3 Planifikimi i prodhimit të xehes së Kromitit Cr_2O_3 për vitin 2017

Në grafikun e më poshtëm është paraqit planifikimi i prodhimit të xehes së Kromitit për vitin vijues, si bazë janë marr parasysh vitet 2013 – 2016.




Figura 34. Paraqitje e prodhimit të Cr_2O_3 dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Prodhimtaria e xehes së kromit sipas shfrytëzimit të gjertanishëm nuk është dëshmuar se ka një qëndrueshmëri, kjo ngase ka vetëm një ndërmarrje të licencuar e cila nuk është treguar e suksesshme. Prodhimtaria e gjertanishme edhe perse shumë e vogël në vitin 2015 është ndërprerë në tërësi. Nga kjo mund të konsiderojmë se nëse bazohemi në kriterin e përdorur dhe për të gjitha mineralet e tjera mund të supozojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të xehes së kromit për vitin 2017 mund të jetë 800.00 ton apo ndoshta dhe 0.00 ton.

5.3.4 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Linjit

Planifikimi i prodhimit të linjtit për vitin 2016 është bazuar në prodhimtarin e realizuar gjatë viteve 2013 – 2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 35. Paraqitje e prodhimitarisë së planifikuar të linjitit për 2016, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Prodhimtaria e linjitit sipas shfrytëzimit të gjertanishëm është pothuajse i njëjtë për çdo vit dhe përderisa sa të punohet më termocentralet aktuale duket të ketë trend të njëjtë të shfrytëzimit, përpos vitit 2014 ku kemi pas një rënie të dukshme të sasisë së shfrytëzuar të linjitit. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të linjitit për vitin 2017 mund të jetë 8,500,000.00 ton.

5.3.5 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Andezite

Planifikimi i prodhimitarisë së andezitit për vitin 2016 është bazuar në prodhimtarin e realizuar gjatë viteve 2013 – 2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 36. Paraqitje e prodhimitarisë së planifikuar të andezitit për 2017, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Në grafikun e më sipërm është paraqitur mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake nga ku rrjedhë se nevoja e shfrytëzimit të andeziteve ka një rënie të ngadaltë deri në vitin 2014, ndërsa ka pësuar rritje të menjëhershme gjatë vitit 2015 dhe rënie në vitin 2016. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të andeziteve për vitin 2017 mund të jetë 50,000.00m³.

5.3.6 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Argjilës

Planifikimi i prodhimit të argjilës për vitin 2017 është bazuar në prodhimtarin e realizuar gjatë viteve 2013 – 2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 37. Paraqitje e prodhimit të planifikuar të argjilës për 2017, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake rrjedhë se nevoja e shfrytëzimit të argjilës nga 2014 e këndej ka një ngritje. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të argjilës për vitin 2017 mund të jetë 250,000.00 ton.

5.3.7 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Gëlqeror

Për planifikim të prodhimit të gëlqerorëve për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2013– 2016, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 38. Paraqitje e prodhimit të gëlqerorëve dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Në grafikun e më sipërm është paraqitur mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake, nga ku vërehet se nevoja e shfrytëzimit të gëlqerorëve ka ndryshime mirëpo me një tendencë rritje graduale. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të gëlqerorëve për vitin 2017 mund të jetë 5,800,000.00 m³.

5.3.8 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Bazalt

Për planifikim të prodhimit të bazaltit për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2013 – 2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 39. Paraqitje e prodhimitarisë së bazaltit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake nga ku rrjedhë së sasia e shfrytëzimit të bazaltit nuk dëshmon rritje, por në të kundërtën gjatë vitit 2015 ka pësuar rënie të dukshme, ndërsa gjatë vitit 2016 nuk ka pas fare shfrytëzim. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të bazaltit për vitin 2017 mund të jetë 3,500.00 m³.

5.3.9 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Dunit

Paraqitje e prodhimitarisë së dunit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016, është bërë në grafikun e më poshtëm.




Figura 40. Paraqitje e prodhimitarisë së bazaltit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake nga ku rrjedhë së sasia e shfrytëzimit të dunitit nuk dëshmon rritje. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të bazaltit për vitin 2017 mund të jetë 380,000.00 m³.

5.3.10 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Rërës dhe zhavorrit

Për planifikim të prodhimitarisë për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2013 – 2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 41. Paraqitje e prodhimitarisë së rërës-zhavorrit dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake. Gjat vitit 2015 ka pas rënie të sasis së shfrytëzuar të rërës dhe zhavorrit, ndërsa gjatë vitit 2016 ka tendencë rritje. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të rërës dhe zhavorrit për vitin 2017 mund të jetë 14,000.00 m³.

5.3.11 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Rërë kuarcore

Për planifikim të prodhimitarisë për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2013 – 2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 42. Paraqitje e prodhimitarisë së rërës kuarcore dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake. Gjatë vitit 2014 ka pas rritje të sasisë së shfrytëzuar të rërës kuarcore, për të renë dukshëm në vitet 2015 dhe 2016. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të rërës kuarcore për vitin 2017 mund të jetë 30,000.00 m³.

5.3.12 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Mergelë

Për planifikim të prodhimitarisë për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2013-2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 43. Paraqitje e prodhimitarisë së mergelës dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Në grafikun e më sipërm është paraqitur dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar në trendin e përgjithshëm të shfrytëzimit në katër vitet paraprake. KPMM-ja për momentin e ka të licencuar një ndërmarrje më dy licenca për shfrytëzim të mergelës. Mundë të vërehet se ka shfrytëzim të qëndrueshëm të mergelës. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të mergelës për vitin 2017 mund të jetë 325,000.00 m³.

5.3.13 Planifikimi i prodhimit për vitin 2017 – Rreshpe

Për planifikim të prodhimitarisë për vitin vijues janë marr parasysh vitet 2013 – 2016, shih grafikun e më poshtëm.




Figura 44. Paraqitje e prodhimitarisë së rreshpeve dhe mesatarja e lëvizshme, e bazuar kjo në prodhimtarin nga 2013-2016

Në përgjithësi vërehet se nga 2014 ka një tendencë rënie të sasis së shfrytëzuar të rreshpeve. Nga kjo mund të konsiderojmë se sasia e planifikuar për shfrytëzim të rreshpeve për vitin 2017 mund të jetë 2,200.00 m³.

Bazuar në shënimet e paraqitura më sipër mbi planifikimin dhe realizimin e prodhimit për lëndë të veçanta minerale, mund të konstatohet se ka një mospërputhje të dukshme në planifikim të prodhimitarisë. Si rezultat i kësaj rrjedhë se pothuajse të gjitha ndërmarrjet duhet bërë planifikime më reale bazuar në vitet paraprake, edhe pse kapacitetet prodhuese të tyre sipas planifikimit janë dukshëm më të mëdha. Si konstatim i përgjithshëm është se kapacitetet shfrytëzuese të ndërmarrjeve dhe sasia e prodhuar për lëndë të veçanta minerale dëshmojnë se numri i ndërmarrjeve të licencuara për momentin e mbulojnë në tërësi tregun vendor dhe madje do të kishte kapacitet dhe për eksport.

Sa i përket lëndëve minerale ndërtimore dhe industriale bazuar në resurset, prodhimin dhe kapacitetet prodhuese konstatojmë se është e nevojshme gjetja e mundësive për eksport të këtyre resurseve. Tek shfrytëzimi i mineraleve jo metalore kryesisht ka ndikim tregu i brendshëm, kjo për arsye se këto resurse pak ose fare nuk eksportohen jashtë vendit.

5.4. Projektet

5.4.1 Kërkime Gjeofizike Elektrometrike në zonën e Guroreve pranë shpellës së Gadimes

Si objekt i këtij projekti ka qenë përcaktimi i prezencës eventuale, apo shtrirjes më të gjerë dhe në thellësi të zbrastësirave karstike nëntokësorë përpos atyre të ditura në shpellën e Gadimes, e në veçanti në zonën në lindje të shpellës ku sot zhvillohet aktivitet mineral. Ngase vazhdimi i veprimtarisë minerare në rast të prezencës së zbrastirave karstike do të mund të qonte deri në rreze të pa pritshme, apo dhe në të kundërtën në rast të prezencës së shpellës në këtë zonë do të ishte me pasoja të riparueshme për bukurit eventuale karstike.

Realizimi i këtij projekti ka sjellë avancime thelbësore në konceptimin bashkëkohor lidhur me ndërtimin gjeologo - strukturor dhe me interpretimin gjeologo - gjeofizik të zonës. Pas një rikunjicioni të detajuar të zonës, dhe disa matjeve test mbi shpellë u përcaktua edhe metodologjia e rlevimit gjeofizik. Nga punimet test u pa që shpella reflektohet me një anomali të rezistencës. Kjo lloj anomalie e Rezistenca e dukshme (Rd), tregon për mundësinë e evidentimit të zonave karstike. Në zonën e Shpellës së Gadimes u kryen rlevime me metodën e gradientit të shumëfishtë, sipas profileve të trasuara me instrument GPS i saktësisë së lartë. Në total janë kryer gjithsej 10 profile me skema të ndryshme, u kryen edhe matje për verifikimin dhe lidhjen e anomalive me njëra tjetrën, si dhe për të parë mundësinë e lidhjes së tyre me zonën e karstëzuar. Rlevimi me të tre metodat Rezistenca e dukshme (Rd), Polarizimi i provokuar (IP) dhe Fusha elektrike natyrore (SP) mundësi të lidhjes së anomalive njëra me tjetrën, dhe të selektimit të zonave të pritëshme karstike. Nga rlevimet gjeofizike duket që ekzistojnë zona anomale




Figura 45. Harta e izolinjave të rezistencës së dukshme

5.4.2 Përpilimi i planit të Menagjimit të Resurseve Minerale të Kosovës, për vitin 2017

Sipas Ligjit për Miniera Minerale Nr.03/-163 Neni 74 respektivisht Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit bazik neni 45, KPMM është e obliguar që: Gjatë tremujorit të fundit të secilit vit kalendarik të përgatit dhe dorëzon në ministri Projekt Planin për Menaxhimin e Resurseve Minerale për vitin vijues, i cili duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Minerare të Kosovës.

Për zhvillim më efektivitet, të sigurt dhe të vazhdueshëm të vendburimeve minerale të Kosovës KPMM-ja merr parasysh disa aspekte më rendësi si: Ofrim i këshillave gjeo-shkencore dhe informata të domosdoshme gjeologjike organeve qeveritare nëse nga ato kërkohet, si dhe palëve të treta sipas interesimit të tyre, koordinim me institucionet e tjera për të siguruar që prioritetet janë të analizuar dhe që planifikimi për të ardhmen është kryer për

një zhvillim më të mirë të vendburimeve minerale të vendit, të sigurohet që institucionet e tjera të mos nxjerrin jashtë përdorimit resurset minerale natyrore, duke ngritur mbi to apo afër tyre çfarëdo infrastrukture etj.

Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës (SMRK) dhe Plani i Menaxhimit të Resurseve minerale të Kosovës (PMRMK) kanë rendësi për caktimin e zonave potenciale për planifikime të veçanta për zhvillim të veprimtarisë minerare.

5.4.3 Skanimi i dokumentacionit gjeologjik te arkivit

KPMM-ja në arkivin e vet përpos dokumentacioneve që kanë të bëjnë me licencimin e aktiviteteve të hulumtimit, shfrytëzimit si dhe leje për aktivitete të veçanta, si pjesë e arkivit të KPMM-së është edhe pjesa e arkivit të vjetër (historik) që natyra e saj është gjeologjike. Në të përfshihen elaborate, raporte gjeologjike të viteve të ndryshme që janë kryer në territorin e Kosovës.

Meqenëse, sipas LMM është e paraparë që dokumentacioni gjeologjik të kalojë tek Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, KPMM-ja ka përfunduar skanimin e të gjithë dokumentacionit gjeologjik. Kështu që dokumentacioni fizik dhe një kopje e dokumentacionit elektronik do t'i dorëzohet Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Një kopje e dokumentacionit elektronik do të qëndrojë në KPMM, përkatësisht për stafin profesional si lehtësim i punës së tyre profesionale.

5.5. Inspektimi dhe monitorimi i aktiviteteve minerare

Inspektorati i Minierave ka kompetencën e përgjithshme për të inspektuar aktivitetet e hulumtimit, shfrytëzimit dhe aktivitetet e veçanta të cilitdo person, për të konstatuar:

- 1.1. nëse personi i cili ushtron ato aktivitete posedon Licencë ose Leje të dhënë nga KPMM;
- 1.2. nëse personi posedon Licencë ose Leje, për të konstatuar nëse aktivitetet janë duke u ushtruar në përputhje me Licencën ose Lejen përkatëse dhe rregulloret zbatuese të sigurisë dhe mjedisore të nxjerra nga Ministri në përputhje me LMM-në.

5.5.1. Zhvillimi i aktiviteteve minerar në KEK

Aktiviteti minerar për shfrytëzimin e linjitit është mjaft kompleks, ngase për të ardhur deri të lënda e parë minerale, paraprakisht duhet larguar djerrina (mbulesa).


Largimi i djerrinës nënkupton fazën paraprijëse të shfrytëzimit të qymyrit(lignitit). Gjatë vitit 2016 KEK-u është planifikuar largimin e masave të djerrinës (mbulesës) në sasinë prej **12,500,000 m³** ndërsa realizimi është bërë në sasinë prej **6,957,674 m³** apo në përqindje **55,7%** .

